



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/44/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala V.S, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares A.N-M, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 12.01.2023 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga V.S ndaj gjyqtares A.N-M për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesja V.S me datë 13.12.2022 përmes email-it dërguar Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares A.N-M.

Me datë 27.12.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtrueses.

Parashtruesja e ankesës V.S ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares A.N-M për shkak të pretendimeve se gjyqtarja nuk e ka trajtuar lëndën A.nr.2401/22 (2022:210815) me kohë sepse padinë e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 13 tetor 2022, dhe gjyqtarja përveçse ka tejkalluar të gjitha afatet ligjore rreth nje vendimi final apo caktimit të ndonjë seance, gjithashtu ka nxjerr aktvendim dëmtues (A.nr.2401/2022) për palën, dhe atë në kundërshtim me ligjin, ku refuzon kërkesën për kthim në punë, kështu duke shkelur ne veçanti ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve nr.06/L- 085, neni 24 paragrafi 4 dhe 5, i cili përcakton: “Në rastet kur gjykata kompetente vërteton se sinjalizuesi në kontest të marrëdhënies se punës ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak te sinjalizimit, vendos sipas rastit, që ta kthej në vendin e tij të punës, t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të urdhëroj institucionin publik të ndërmarrë veprime të caktuara”, ndërsa në par. 5 parashihet: “Të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga Gjykata”. Tutje në ankesën e saj, parashtruesja ka theksuar se, me datë 8.dhjetor 2022, pas pranimit te aktvendimit ku refuzohet kërkesa për kthim në pune, ka shkuar në zyrën gjyqtares dhe e ka njoftuar se lënda është me dy prioritete: është

sinjalizuese dhe ka humbur vendin e punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore, ndërsa gjyqtarja i ka thënë se rastet e vitit 2022 nuk janë prioriteti i saj.

Në fund të ankesës së saj, parashtruesja ka theksuar se, gjyqtarja është përgjegjëse për shkeljet disiplinore, të parapara në ligjin 06/L57 neni 5 paragrafi 2.7 (në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare në kohe, siç kërkohet me ligj) si dhe paragrafi 2.15 (përfshihet në sjellje, qofte kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmëri ose besueshmërinë e gjyqësorit).

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtarja A.N-M ka deklaruar se, është e vërtetë se një kategori e lëndëve kryesisht kontestet nga marrëdhënia e punës, çështjet e diskriminimit dhe çështjet që bien në fushëveprim të Ligjit për Sinjalizim kërkohet të trajtohet me prioritet. Ka shtuar se, sa i përket afateve kohore për trajtimin e lëndëve me prioritet, ligjet specifike dhe as praktika gjyqësore nuk definojnë afate strikte kohore brenda të cilave duhet të zhvillohen procedurat e shqyrtimit gjyqësor. Këto ligje vetëm se parashohin marrjen e lëndëve të kësaj natyre me prioritet, para lëndëve të tjera, në caktimin e afateve sa më të shkurtra për mbajtjen e seancave gjyqësore.

Tutje në deklaratën e saj, gjyqtarja A.N-M ka theksuar se, lënda në fjalë është regjistruar pak më tepër se 2 muaj më parë dhe në këtë rast tanimë është ndërmarrë veprimi i parë procedural (aktvendim) lidhur me kërkesën e parashtruar për caktimin e masë të përkohshme – kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit administrativ. Ka shtuar se, për këtë arsye pretendimet ankimore të parashtrueses janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme të cilat nuk bazohen në asnjë provë, ndërsa sa i përket caktimit të seancës për shqyrtim kryesor, seanca do të caktohet konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Më tej në deklaratën e saj, gjyqtarja ka theksuar se, paditësja i ka shkuar në zyre dhe e ka pyetur lidhur me statusin e lëndës ndërsa gjyqtarja e ka informuar se në cilën fazë ndodhet lënda në shqyrtim. Në fund të deklaratës së saj, gjyqtarja ka shtuar se, si është e mundur që paditësja i ka shkuar në zyre pa kryer asnjë verifikim.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarës ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës A.N-M lidhur me procedurën e zhvilluar dhe aktvendimit të marrë në lëndën A.nr.2401/22 (2022:210815), për të cilën parashtruesja është ankuar.

Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, fillimisht e sheh të nevojshme të sqarojë se, palët në procedurë nuk mund të takohen me gjyqtarët gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore pa pasur takim të përcaktuar, apo pa pasur thirrje nga gjykata, sepse kjo mund të konsiderohet si ndërhyrje në punën e gjyqtarëve. Për më tepër, nëse palët në procedurë dëshirojnë të informohen për statusin e lëndës, mund t'i drejtohen gjyqtarëve apo Kryetares së Gjykatës në formë të shkruar për t'u informuar rreth procedurës gjyqësore, e jo të shkojnë direkt në zyrat e gjyqtarëve.

Lidhur me pretendimin ankimor, se gjyqtarja e rastit nuk e ka trajtuar lëndën me prioritet, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk qëndron ky pretendim ankimor për faktin se, në lëndën A.nr.2401/22 janë ndërmarr veprime procedurale të natyrës urgjente, konkretisht është vendosur për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të së paditurës (Ministria e Drejtësisë - Institutit të Mjekësisë Ligjore), ndërsa sa i përket caktimit të seancave gjyqësore për kontestet nga marrëdhënia e punës, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se, ligjet specifike

dhe as praktika gjyqësore nuk përcaktojnë afate kohore brenda të cilave duhet të caktohen seancat gjyqësore, por vetëm parashohin se seancat gjyqësore të kontestet nga marrëdhënia e punës caktohet me prioritet në raport me lëndët tjera, andaj duke qenë se lënda në fjalë, në gjykatë është pranuar në muajin tetor 2022, pra afër 3 muaj dhe tashmë është marrë veprimi i parë procedural lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ, Autoriteti i kësaj gjykate konsideron se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Lidhur me pretendimin e parashtrueses së gjyqtarja A.N-M ka qenë e njëanshme në veprimet e saj gjatë procedurës në lëndën A.nr.2401/22 duke ia refuzuar parashtrueses kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit administrativ të së paditurës, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate në pah se nuk ka të drejtën e komentimit të vendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga gjyqtarja, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë”.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate konsideron se, për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore, dhe për këtë Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja A.N-M ka kryer shkelje disiplinore, për t’i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/44/22, me datë 12.01.2023

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë